



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar

Tiranë, më 26.06.2019

R A P O R T

PËR DEKRETIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS NR.11195, DATË 31.05.2019, “PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 26/2019 “PËR SHËRBIMIN PËRMBARIMOR GJYQËSOR PRIVAT””

I. HYRJE

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (*Komisioni*), në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 26 Qershor 2019, mori në shqyrtim dekretin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, nr.11195, datë 31.05.2019, “Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e dekretit deputeten Vasilika Hysi.

Komisioni e shqyrton këtë dekret, në zbatim të nenit 86 dhe në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Bazuar në nenin 26, pika 7, të Rregullores së Kuvendit, ky dekret përfshihet automatikisht në programin e punës së Kuvendit.

Për të zhvilluar procedurën e shqyrtimit të dekretit, në mbledhjen e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, përfaqësues të Dhomës Kombëtare të Përmbartuesve Gjyqësorë Privat.

Komisioni i dërgoi ftesë Institucionit të Presidentit të Republikës dhe Misionit EURALIUS. Në vijim të ftesës së dërguar nga Komisioni, përfaqësuesi i institucionit të Presidentit të Republikës dhe Misioni EURALIUS njoftuan Komisionin se për shkak të angazhimit në një aktivitet tjetër nuk mund të ishin të pranishëm në mbledhje.

II. BAZA LIGJORE PËR SHQYRTIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë:

Neni 85

1. Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë.
2. Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humbet fuqinë, kur kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Neni 86

Dekreti i Presidentit të Republikës për rishqyrtim ligji

1. Kur Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 85 të Kushtetutës, rikthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend, Kryetari i Kuvendit e kalon menjëherë atë për shqyrtim në komisionin përgjegjës që e ka shqyrtuar fillimisht.
2. Komisioni përgjegjës e shqyrton dekretin vetëm për çështjet e paraqitura nga Presidenti i Republikës dhe brenda 8 javëve nga data e fillimit të shqyrtimit paraqet raportin e tij. Ky raport përmban mendimin e komisionit dhe, sipas rastit, edhe propozime për nene të veçanta të ligjit.

III. ARSYET PËR KTHIMIN E LIGJIT SIPAS DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

Me Dekretin nr. 11195, datë 31.05.2019, Presidenti i Republikës vendosi kthimin e ligjit nr.26/2019 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”. Në materialin shpjegues të dekretit, Presidenti çmon se, dispozita të veçanta të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat” duhet të rishikohen me qëllim qartësimin dhe përmirësimin e tyre.

Në dekretin e Presidenti i Republikës, “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat” argumentohet se ligji i paraqitur për shpallje në tërësinë e tij është një akt ligjor pozitiv në drejtim të zhvillimit të shërbimit përmbartimor privat.

Nga ana tjetër, në vlerësimin e paraqitur në pjesën argumentuese të dekretit, theksohet se disa dispozita të veçanta të këtij ligji, konkretisht: **neni 2, pika 2 shkronja “b”;** **neni 9 pika 1 dhe 2;** neni 12 pika 1; nenet 58-60; neni 59, pika 4, si dhe neni 88, pika 1, 2 paraqesin paqartësi në formulimin e tyre dhe nuk janë në harmoni me legjislacionin aktual në fuqi, shkaqe këto që sipas vlerësimit të institucionit të Presidentit të Republikës, mund të sjellin zbatim të gabuar në praktikë ose keqinterpretim me pasojë cënimin e parimeve kushtetuese të sigurisë juridike, si dhe nismës dhe veprimtarisë së lirë ekonomike.

Në arsyetimin e dekretit për kthimin e ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”, Presidenti i Republikës ka parashtruar disa argumente ku bazon përfundimin e tij, të cilat po i parashtrorjmë si vijon:

Argumenti 1: Parashikimet e **nenit 2, pika 2/b**, të ligjit nr.26/2019, nuk janë në harmoni me parashikimet e Pjesës IV, nenet 510, e vijues, të Kodit të Procedurës Civile, të cilat përcaktojnë

rolin dhe funksionet kryesore të permbaruesit gjyqësor, si dhe bie ndesh me legjislacionin ekzistues që rregullon profesione të tjera.

Ky lloj shërbimi ku permbaruesi gjyqësor privat do të angazhohet në mbledhjen e detyrimeve financiare me mirëkuptim, e përafron profesionin e permbaruesit me rolin e ndërmjetësit. Nëpërmjet kryerjes së kësaj veprimtarie dytësore permbaruesi, në kundërshtim me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, shfaqet dhe hyn në veprim në një proces të mbledhjes së detyrimeve jo në rastin që ka diktuar Kodi i Procedurës Civile; pra, pas lëshimit nga gjykata të urdhrit të ekzekutimit, por shumë kohë përpara, duke marrë një rol aktiv negociator për arritjen e mirëkuptimit nga debitori për shlyerjen e detyrimit, parashikim ky që bie ndesh edhe me rolin që ligji nr.10385, datë 24.02.2011, "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve", i ndryshuar, i ka dhënë profesionit të ndërmjetësit.

Dispozita e nenit 12, pika 1, e ligjit nr.26/2019 ka nevojë për përmiresim, pasi është jo e plotë sa i takon papajtueshmërisë së funksionit të permbaruesit me çdo veprimtari private. Në këtë dispozitë duhet të shtohet edhe shkaku tjetër i papajtueshmërisë që është papajtueshmëria e këtij profesioni me veprimtaritë e tjera publike ose private, pasi në mënyrën sesi është formuluar kjo dispozitë nuk është e qartë gjendja e papajtueshmërisë dhe sipas kësaj dispozite duket sikur permbaruesi është i lirë të kryejë veprimtari të tjera private, mjafton që kjo të mos cenojë funksionin e tij si permbarues.

Argumenti 2: *Përmbajtja e nenit 9, pika 1, e ligjit nr. 26/2019 "Për shërbimin permbarimor gjyqësor privat", nuk përcakton një mekanizëm të qartë ligjor për të vënë në dukje nevojën reale mbi përcaktimin e numrit të përgjithshëm të permbaruesve gjyqësorë privatë, si dhe shtrirjen e këtij shërbimi në të gjithë territorin e vendit.*

Për sa i takon numrit të banorëve që mundet një permbarues të ofrojë shërbimin e tij, pra 1 permbarues për 20 mijë banorë, mund të jetë një kriter krejtësisht objektiv, por parashikimi se indikator për të përcaktuar banorët "rezidentë", merret nga të dhënat zyrtare të censusit të fundit të përgjithshëm të popullsisë dhe banesave, mund të krijojë një çështje problematike, që mund të ndikojë në mirëfunksionimin e këtij shërbimi. Njëkohësisht, përdorimi i termit "nevojë publike", nuk i jep mundësi Ministrisë të Drejtësisë të përcaktojë vendimmarrjen e tij, mbi të dhëna objektive dhe transparente për shtimin ose pakësimin, sipas rastit, të numrit të përgjithshëm të permbaruesve gjyqësorë privatë.

Arsyetimi 3: *Dispozitat e neneve 58, 59, 60 nuk janë të plota dhe në harmoni me parashikimet e ligjit nr. 8678, date 14.05.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar. Veçanërisht, pika 4 e nenit 59, në formën e miratuar, është e paqartë, çka mund të përbëjë shkak që, në praktikë, kjo dispozitë të zbatohet në kundërshtim të hapur me parimet e Kodit të Procedurës Civile e legjislacionin ekzistues, si dhe vet ligjin e miratuar.*

Argumenti 4: *Parashikimet e nenit 88, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 26/2019 nuk janë të qarta dhe në formën e miratuar, çënojnë parimin kushtetues të sigurisë juridike dhe me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon ligji nr. 26/2019.*

Argumenti 5: *Në kushtet kur Shërbimi Permbarimor Gjyqësor Privat është funksion publik i deleguar dhe paraqet fazën përfundimtare të vënies në vend të së drejtës së fituar me vendim gjyqësor, në këtë ligj mund të ishte parashikuar në mënyrë të kujdesshme dhe objektive edhe kryerja e një procesi rivlerësimi kalimtar (vetting) për të gjithë subjektet, që gëzojnë çertifikata*

ose licenca të ushtrimit të shërbimit përmbarrimor privat, me qëllim rivlerësimin e aftësive të tyre profesionale, etike dhe morale.

Argumenti 6: *Gjatë procesit të diskutimit dhe miratimit të akteve në kuadër të realizimit të reformës në sistemin e drejtësisë, Kuvendi nuk i ka kushtuar të njëjtën vëmendje edhe reformimit të shërbimit përmbarrimor gjyqësor shtetëror. Është përgjegjësi e Qeverisë dhe e Kuvendit të Shqipërisë që të kujdeset për përmirësimin e njëtrajtshëm të legjislacionit, për të dy këto shërbime përmbarrimore (shtetërore dhe private), në mënyre që cilësia e veprimtarisë së tyre të ofrojë mundësisht të njëjtin standard të trajtimit me ligj.*

IV. SHQYRTIMI I ARSYEVE TË KTHIMIT TË LIGJIT

Gjatë shqyrtimit të dekretit në Komisionin për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë u shprehën se ligji nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat” saktëson rolin e përmbarruesit gjyqësor privat, disiplinon shërbimin përmbarrimor gjyqësor si dhe vendos kritereve dhe kushteve ligjore të qarta dhe transparente për të ushtruar profesionin e përmbarruesit gjyqësor privat si dhe sanksionuar qartë rolin kontrollues të Ministrisë së Drejtësisë.

Në lidhje me mekanizmin e parashikuar në ligj, sipas të cilit Ministri i Drejtësisë, në varësi të nevojës publike dhe në bazë të propozimit të arsyetuar të Dhomës Kombëtare të Përmbarruesve Gjyqësorë Privatë, mund të mund të caktojë një numër më të madh ose më të vogël të përmbarruesve gjyqësorë privatë, përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë u shprehën se ky institucion disponon të gjitha burimet dhe mjetet e nevojshme për të bërë një vlerësim objektiv për nevojën e marrjes së shërbimit përmbarrimor në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Dhoma Kombëtare e Përmbarruesve Gjyqësorë Privatë, nëpërmjet shkresës nr. 589, datë 12.06.2019, ka paraqitur argumente të hollësishme lidhur me arsyet e parashtruara në Dekretin e Presidentit të Republikës duke u shprehur njëkohësisht se ligji është i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë ka kaluar një fazë të gjatë diskutimesh dhe konsultimesh përpara finalizimit të tij dhe adreson problematikat e lindura në praktikë, mbështetur në standartet më të mira ndërkombëtare.

Në vazhdim të diskutimit, anëtarët e Komisionit paraqitën opinionin e tyre lidhur me argumentet e paraqitura nga Presidenti i Republikës në Dekretin për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat”.

Lidhur me çështjet e ngritura në dekretin e Presidentit të Republikës, relatorja znj.Vasilika Hysi, paraqiti argumentet dhe vlerësimet për arsyet e parashtruara si më poshtë vijon:

Së pari: *Në lidhje me argumentin sipas të cilit “parashikimet e nenit 2, pika 2 shkronja “b”, të ligjit nr.26/2019, nuk janë në harmoni me parashikimet e Pjeses IV, nenet 510, e vijues, të Kodit të Procedurës Civile, të cilat përcaktojnë rolin dhe funksionet kryesore të përmbarruesit gjyqësor, si dhe bie ndesh me legjislacionin ekzistues që rregullon profesione të tjera”*

Nenet 510 e vijues të Kodit të Procedurës Civile trajtojnë në mënyrë të detajuar procedurën e ekzekutimit të titujve ekzekutivë. Kryerja e veprimeve procedurale për vënien në ekzekutim të titujve ekzekutivë sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile dhe akteve të tjera ligjore për ekzekutimin e titujve ekzekutiv realizohet nga shërbimi përmbarrimor gjyqësor, qoftë ai shtetëror qoftë shërbimi përmbarrimor gjyqësor i organizuar mbi baza private.

Përpos këtij funksioni kryesor të shërbimit përbarimor gjyqësor privat, ligji ka parashikuar veprimtarinë dytësore të përbaruesit gjyqësor privat duke detajuar shërbimet që do të konsiderohen si veprimtari dytësore.

Pika 2 e nenit 2 të ligjit zgjeron funksionaliteti dhe rolin publik të përbaruesit gjyqësor privat në sistemin e drejtësisë, nëpërmjet asistencës së ofruar sistemit gjyqësor dhe ofrimit të shërbimeve në interes të publikut. Në këtë kuadër në hartimin e këtij neni janë mbajtur parasysh:

- Hamonizimi i ligjit me ndryshimet e miratuara së fundmi në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile;
- Harmonizimi ligjit me standardet e parashikuara në Udhëzuesin Nr. 11, datë 17 Dhjetor 2009, të Komisionit Europian për Eficiencën në Sistemin e Drejtësisë (CEPEJ) “*Mbi implementimin e rekomandimit të Këshillit të Evropës për ekzekutimin*” si dhe me përcaktimet e bëra në Kodin Global të Ekzekutimit të Detyruar. Në pikën 34 të udhëzuesit të CEPEJ dhe në nenin 21 të Kodit Global të Ekzekutimit të Detyruar është parashikuar si një nga veprimtaritë dytësore të përbaruesve gjyqësor privat “mbledhja e detyrimeve financiare me mirëkuptim”;

Parashikimi i veprimtarisë dytësore të përbaruesve gjyqësor privat nuk bie ndesh me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, pasi dispozitat e këtij Kodi, rregullojnë veprimtarinë përbarimore në funksion të ekzekutimit të titujve ekzekutiv, ndërkohë që veprimtaria dytësore e përbaruesve gjyqësor privat nuk është e lidhur me ekzekutimin e titujve. Kjo është një veprimtari, e cila është në përputhje me rolin, përgjegjësitë që përbaruesi gjyqësor privat kryen duke marrë në konsideratë të gjithë procesin e verifikimit dhe kualifikimit profesional, që një individ duhet të kalojë për t'u pajisur me licencën e ushtrimit të veprimtarisë përbarimore.

Në vlerësimin tonë, veprimtaria dytësore e përbaruesve gjyqësor privat nuk krijon në asnjë moment mbivendosje ose konflikt kompetencash me ushtrimin e profesionit të lirë të ndërmjetësit dhe detyrat që Kodi i Procedurës Civile dhe ligji i posaçëm nr. 10385/2011 “*Për ndërmjetësimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve*”, i ndryshuar, kanë parashikuar që kryhen prej tyre.

Ndërmjetësimi, sipas kuptimit të dhënë nga legjislacioni në fuqi për ndërmjetësimin, zbatohet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fushën e së drejtës civile, tregtare, të punës dhe familjare, pronësinë intelektuale, të drejtat e konsumatorëve, mosmarrëveshjeve midis organeve të administratës publike dhe subjekteve private, mosmarrëveshjet që shqyrtohen nga gjykata me kërkesën e viktimës akuzuese, ose me ankim të të dëmtuarit, në çdo kohë që palët në konflikt, me vullnetin e tyre të lirë, kërkojnë dhe pranojnë ndërmjetësimin si alternativë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, pavarësisht nëse mosmarrëveshja është paraqitur përpara organit të përcaktuar nga ligji për zgjidhjen e saj.

Dispozitat e ligjit nr.10385/2011 “*Për ndërmjetësimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve*”, i ndryshuar zbatohen edhe në ato raste kur gjykata, ose organi përkatës shtetëror, pas vënies në lëvizje për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, njofton dhe udhëzon palët drejt ndërmjetësimit.

Nesë i referohemi kuptimit, që ligji nr.10385/2011 ka dhënë për ndërmjetësimin, fushën e zbatimit të tij si dhe të drejtat dhe detyrat e ndërmjetësve rezulton se këto parashikime nuk kanë dhe as nuk krijojnë premisën për mbivendosje me veprimtarinë dytësore të përbaruesve gjyqësor privat. Njëkohësisht, përdorimi i termit “mirëkuptim” në përmbajtjen e nenit 2 pika 2/b nuk është i lidhur në asnjë moment me zbatimin e institutit të ndërmjetësimit. Nocioni i mirëkuptimit në këtë rast është përdorur në përputhje me nenin 21 të Kodit Global të Ekzekutimit të Detyruar.

Përsa i përket nevojës për të qartësuar përmbajtjen e pikës 1 të nenit 12, lidhur me papajtueshmërinë me ushtrimin e veprimtarisë së përmbaruesit gjyqësor privat, vlerësojmë se parashikimi është i qartë dhe shterues në përmbajtjen e tij. Përdorimi i termit “njëkohësisht” përjashton mundësinë që një përmbarues gjyqësor privat të ushtrojë njëkohësisht edhe funksionin publik të “deleguar” të përmbaruesit edhe funksione, profesione ose veprimtari të tjera. Mënyra se si është formuluar dispozita nuk lë asnjë vend për interpretim dhe rastet e papajtueshmërisë janë të parashikuara në mënyrë specike në këtë nen, me qëllim shmangien e çdo situatë të mundshme konflikti interesi dhe sigurimin e mbrojtjes së barabartë të të drejtave të kreditori dhe debitorit në një proces ekzekutimi të detyrueshëm.

Së dyti: Lidhur me argumentin sipas të cilit përmbajtja e nenit 9, pika 1, e ligjit nr.26/2019 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat", nuk përcakton një mekanizëm të qartë ligjor për të vënë në dukje nevojën reale mbi përcaktimin e numrit të përgjithshëm të përmbaruesve gjyqësorë private, si dhe shtrirjen e këtij shërbimi në të gjithë territorin e vendit.

Ligji ka parashikuar një dispozitë të veçantë lidhur me numrin e përgjithshëm të përmbaruesve gjyqësor privat. Udhërrëfyesi i 2009 i CEPEJ parashikon që shtetet anëtare duhet t'i kushtojnë një vëmendje të veçantë shpërndarjes gjeografike të përmbaruesve në mënyrë që të sigurohet një mbulim i përshtatshëm i territorit, konkurrencë e mjaftueshme dhe kompetenca tokësore të mirëpërcaktuara.

Ligji parashikon 1 përmbarues për 20 000 banorë rezidentë dhe disa kritere transparente mbi të cilat do të mbështet vendimmarrja për përcaktimin e numrit të përmbaruesve gjyqësor privat, në çdo rreth gjyqësor. Në këtë rregullim janë mbajtur parasysh jo vetëm standardet e përcaktuara në Udhërrëfyesin e cituar më sipër, por edhe modele të ligjeve të vendeve të rajonit të cilat rregullojnë shërbimin përmbarimor gjyqësor privat, si ligji i Kosovës, ligji bullgar, etj.

Referuar të dhënave që konsultohen lehtësisht në faqen zyrtare të Unionit Ndërkombëtar të Përmbaruesve Gjyqësorë (UIHJ), lidhur me numrin e përgjithshëm të përmbaruesve gjyqësorë privatë, që ushtrojnë veprimtarinë në territorin e shteteve të Bashkimit Evropian, por dhe më gjerë, rregulli dhe përcaktimi i raportit të përmbaruesve gjyqësorë/për banorë rezidentë që parashikon ligji nr. 26/2019 ka përafrim të njëjtë në kahun pozitiv me shtetet evropiane.

Në dekretin e Presidentit të Republikës argumentohet se treguesi për të përcaktuar numrin e banorëve rezidentë, merrret nga të dhënat zyrtare të censusit të fundit të përgjithshëm të popullsisë dhe banesave, mund të krijojë një çështje problematike, që mund të ndikojë në mirëfunksionimin e këtij shërbimi.

Lidhur me sa më sipër, vlerësojmë të nevojshme të qartësojmë se i njëjti parashikim dhe e njëjta terminologji është përdorur edhe në nenin 10 të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”. Censusi i popullsisë dhe banesave është i proces i parashikuar në ligjin nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare” (neni 3) si dhe në ligjin nr. 8669/2000 “Për censusin e përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave”, i ndryshuar.

Censusi i përgjithshëm i popullsisë dhe banesave referuar objektit të këtij ligji, synon t'u ofrojë Kuvendit, Qeverisë, njësitë të qeverisjes vendore, organizatatve ekonomike, shkencore dhe kulturore, si dhe gjithë shoqërisë civile të dhëna të besueshme statistikore, të nevojshme për planifikimin dhe realizimin e politikave të përgjithshme të zhvillimit, për analizat private dhe publike të vendimmarrjes, për kërkime shkencore dhe në përgjithësi, për përmirësimin e njohjes dhe të të kuptuarit nga shtetasit të realitetit demografik, ekonomik dhe shoqëror të vendit.

Censusi ofron të dhëna për: a) numrin dhe shpërndarjen gjeografike të popullsisë rezidente (banuese); b) strukturën demografike dhe karakteristikat kryesore të popullsisë; c) numrin, shpërndarjen gjeografike dhe strukturën e banesave dhe të ndërtesave, që përdoren për qëllime banimi; ç) kushtet e strehimit të popullsisë. Censusi organizohet dhe zbatohet nga Instituti i Statistikave (INSTAT) nën mbikëqyrjen e Komisionit Qendror të Censurit dhe me mbështetjen e komisioneve të censurit, në qarqe dhe të zyrave të censurit në bashki. Censusi i popullsisë dhe banesave është një proces që realizohet sipas një kornize të mirëpërcaktuar ligjore dhe që referuar kuptimit të dhënë në objektin e ligjit nr. 8669/2000 synon të ofrojë të dhëna statistikore të nevojshme për realizimin e politikave specifike të zhvillimit.

Në këtë aspekt, vlerësojmë se ky është një tregues i mirë rregulluar dhe i referuar edhe nga ligje të tjera dhe në këtë aspekt nuk vlerësohet se mund të krijojë problematika, për më tepër në dekretin e Presidentit përmendet vetëm mundësia e problematikës, por nuk referohet në mënyrë specifike problematika që mund të krijohet.

Ligjvënësi është treguar i kujdesshëm që shërbimi përbarimor gjyqësor privat t'i afrohet shtetasve kudo në territor. Kjo dëshkohet me faktin se gjatë diskutimeve të projektligjit në komision, Komisioni ndryshoi projektin e depozituar nga nismëtarët, i cili parashikonte raportin 1 përbarues për 50 000 banorë. Ligji i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë ka përcaktuar 1 përbarues për 20 000 banorë rezidentë.

Në lidhje me shqetësimin e Presidentit sipas të cilit termi “nevojë publike” është evaziv dhe nuk përcakton në mënyrë të qartë indikatorët për përcaktimin e këtij kriteri, e gjejmë me vend të sqarojmë se ky problem nuk qëndron.

Në lidhje me shërbimin përbarimor gjyqësor, Ministria e Drejtësisë është institucioni rregullator, kontrollues i ofrimit të këtij shërbimi, por njëkohësisht edhe institucioni politik-bërës në këtë fushë. Për rrjedhojë, në ndërmarrjen e kësaj politike (rritjen ose uljen e numrit të përgjithshëm të përbaruesve gjyqësorë privatë) Ministria e Drejtësisë disponon të gjithë informacionin, të dhënat dhe instrumentet e nevojshme për të vlerësuar në lidhje me volumin, mbulimin e territorit me shërbim përbarimor me qëllim marrjen e një vendim të mbështetur dhe objektiv.

Përpos kësaj legjislatori në respektim të parimit të transparencës ka vendosur edhe kritere mbi të cilat do të mbështet vendimmarrja për përcaktimin e numrit të përbaruesve gjyqësor privat, në çdo rreth gjyqësor të tilla si:

- a) Vëllimi i punës së veprimtarisë përbarimore;
- b) Zhvillimi ekonomik rajonal;
- c) Veçoritë e territorit dhe mjetet e konunikimit dhe transportit dhe mbulimin me shërbim përbarimor gjyqësor privat në rang kombëtar.

Së treti: Për sa i takon argumentit sipas të cilit parashikimet e 58, 59, 60, nuk janë të plota dhe në harmoni me parashikimet e ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar:

Pika 18/1 e nenit 6 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” i ndryshuar, ka parashikuar që Ministria e Drejtësisë mbikëqyr, kontrollon, inspekon dhe bën procedim disiplinor për profesionin e noterit, përbaruesit privat,

ndërmjetësit, administratorit të falimentimit dhe të profesioneve të tjera të lira, të lidhura me sistemin e drejtësisë, **sipas parashikimeve të legjislacionit të posaçëm në fushën përkatëse.**

Kompetencat kontrolluese dhe rregullatore të ministrisë së Drejtësisë në drejtim të veprimtarisë së përmbauesve gjyqësorë privat janë detajuar në dispozitat e ligjit nr. 26/2019. Duke filluar nga neni 14 i tij, dispozitat e ligjit kanë përcaktuar përgjegjësitë dhe rolin e ministrit të Drejtësisë në licencimin, kontrollin e veprimtarisë përmbauese dhe procesin disiplinor. Ligji ka përcaktuar në mënyrë të qartë, se Ministria është organi përgjegjës për kontrollin e veprimtarisë së përmbauesve gjyqësorë privat, dhe marrjen e masave për të eliminuar shkeljet e konstatuara. (neni 58 i ligjit).

Ndërkohë, ligji ka rregulluar edhe procesin mbikëqyrës, që Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësor Privatë do të ushtrojë ndaj përmbauesve gjyqësorë vetëm në tre drejtime të cilat në asnjë moment nuk krijojnë mbivendosje ose konflikt kompetencash me përgjegjësitë dhe rolin e Ministrisë së Drejtësisë dhe që janë të lidhura me:

- a) Respektimin e Kodit të Etikës;
- b) Respektimin e standardeve profesionale;
- c) Përmbushjen e detyrimeve si anëtar i Dhomës.

Roli i Dhomës si mbikëqyrës i veprimtarisë përmbauese në tre drejtimet e sipërcituara është përcaktuar qartësisht në nenin 59 të ligjit. Dhoma në ushtrimin e funksioneve të saj mbikëqyrëse për tre kompetentët e mësipërm do të ketë edhe tagra për parandalimin e mangësive të lidhura vetëm me këto tre komponentë. Dispozita përcakton qartësisht se Dhoma nuk kryen në asnjë rast dhe në asnjë moment hetim disiplinor. Kjo është prerogativë e Ministrisë së Drejtësisë në mbështetje të standardeve të përcaktuara në nenet 62- 71 të ligjit.

Lidhur me argumentet e sjella nga Presidenti i Republikës, vlerësojmë se ato nuk qëndrojnë.

Së katërti: Për sa i takon argumentit për cënimin e parimit të sigurisë juridike nga përmbajtja e nenit 88 pikat 1 dhe 2 sqarojmë se, në lidhje me pikën 1 të nenit 88 të termi “mbeten të vlefshme për sa kohë nuk bien ndesh me parashikimet e këtij ligji” është një dispozitë tranzitore e cila synon të garantojë të drejtat e fituara përpara hyrjes së fuqi të këtij ligji dhe jo cënimin e tyre.

Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka theksuar se parimi i sigurisë juridike përfshin besimin te sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore. Rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijimësinë e tyre.

Si rregull, nuk mund të mohohen interesa dhe pritshmëri të ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion. Shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë vetëm nëse ndryshimi sjell pasoja pozitive Gjithashtu, Gjykata është shprehur se për të kuptuar dhe zbatuar drejt parimin e sigurisë juridike, kërkohet, nga njëra anë, që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t'i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të dhe, nga ana tjetër, vetë ligji të mos qëndrojë statik nëse duhet t'i japë formë një koncepti.

Në këtë aspekt, legjislatori nëpërmjet vendosjes së rregullave kalimtare në mbështetje të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese ka synuar ruajtjen e parimit të sigurisë juridike. Sigurisht që nëse pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri një përmbaues gjyqësor privat dënohet me vendim

gjqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale sipas përcaktimeve të nenit 16 shkronja “e” ai nuk mund të viijojë të ushtrojë funksionin të përmbaruesit gjyqësor privat, ndaj tij do të merret masa e ç regjistrimit nga regjistri i përmbaruesve gjyqësor privat dhe regjistri unik i përmbaruesve gjyqësorë privat dhe zyra të përmbarimit privat.

Ky ka qënë edhe qëllimi i legjislatorit ruajtja e një balance të drejtë ndërmjet parimit të sigurisë juridike nga njëra anë, por edhe mbrojtja e interesave të palëve në një procedurë përmbarimore nga ana tjetër. Lidhur me argumentet e sjella nga Presidenti i Republikës, vlerësojmë se ato nuk qëndrojnë.

Së pesti: Në lidhje me nevojën për kryerjen e një procesi rivlerësimi kalimtar (vetting) për të gjithë subjektet që gëzojnë certifikata apo liçenca të ushtrimit të shërbimit përmbarimor privat, me qëllim rivlerësimin e aftësive të tyre profesionale, etike dhe morale:

Paralelisht me procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, reforma e sistemit të drejtësisë është shoqëruar edhe me një reformim të thellë të profesioneve të lira: si avokatia, noteria, përmbarimi gjyqësor privat, ndërmjetësimi etj. Duke u nisur edhe nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese e cila në rastin e profesionit të noterit është shprehur se citojmë:

“Gjykata Kushtetuese konkludon se funksioni i noterit në thelb është një funksion publik i “deleguar”, qëllimi i të cilit është që të realizohet një shërbim i pavarur, i paanshëm, profesional e konfidencial në autentifikimin e një kategorie mjaft të rëndësishëm dokumentesh. Pikërisht për të garantuar parametrat e besueshmërisë së noterëve në ushtrimin e drejtë të autoritetit që u është deleguar nga shteti, janë parashikuar me ligj rregulla të veçanta për organizimin e veprimtarisë, kriteret e ushtrimit, dhënia dhe heqja e së drejtës së profesionit, etj., në themel të reformimit të këtyre profesioneve të lira ka qënë:

- a) Përcaktimi i kriterëve dhe kushteve ligjore të qarta dhe transparente për të ushtruar këto profesione të lira të cilat, synojnë prurjet më cilësore dhe me integritet moral dhe profesional;
- b) Rregullimin e detajuar i procesit të edukimit profesional, nëpërmjet sistemit të trajnimit fillestar si parakusht për fitimin e titullit profesional dhe trajnimin vazhdues për personat e licencuar dhe që ushtrojnë profesionin si dhe krijimi i Shkollave/Qendrave përkatëse të trajnimit;
- c) Rregullimi ligjor i kompetencave të secilit organ drejtues të Dhomave përkatëse;
- d) Rritja e profesionalizmit, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies në ushtrimin e këtyre profesioneve të lira si dhe garantimit të interesit publik;
- e) Parashikimi i garancive të nevojshme procedurale gjatë procesit disiplinor në përputhje me standardet e procesit të rregullt ligjor të sanksionuara nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;

Për këtë arsye, vlerësojmë se të gjitha risitë e përcjella nga ligji nr. 26/2019, “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat” si dhe nga ligjet e tjera rregullatore të profesioneve të lira kanë si qëllim parësor reformimin rrënjësor të këtyre profesioneve për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës dhe kthimin e besimit të publikut tek drejtësia.

Së gjashti: Në lidhje me çështjen e fundit se reformimit të shërbimit përmbartimor gjyqësor privat duhet të bëhet paralelisht me shërbimin përmbartimor gjyqësor shtetëror shprehemi se gjatë fazës së diskutimit të ligjit nr.26/2019, vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe nevojës për reformimin e shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror. Pavarësisht se këto profesione rregullohen nga baza ligjore të ndryshme të cilat nuk ndikojnë tek njëra tjetra, është theksuar nevoja që nga institucioni politikbërës, pas studimit të problematikave të ndërmerret nisma ligjore që do të garantojë rritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve edhe nga shërbimi përmbartimor gjyqësor shtetëror.

Në përfundim, duke vlerësuar se nenet e kontestuara në Dekretin nr.11195, datë 31.05.2019, të Presidentit të Republikës, janë hartuar qartë, në harmoni me gjithë dispozitat e tjera të ligjit dhe janë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile dhe legjisllacioni në fuqi, relatorja ftoi anëtarët e Komisionit që të votojnë kundër Dekretit të Presidentit.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut me votat e të anëtarëve të pranishëm vendosi rrëzimin e Dekretit të Presidentit të Republikës, nr.11195, datë 31.05.2019, “Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat” dhe ia përcjell për votim seancës plenare.

RELATORE

KRYETARI

Vasilika HYSI

Ulsi MANJA